

- Trajtimi me profesionalizëm dhe me kohë i rasteve të diskriminimit gjinor në punë,
- Numër më i madh të grave në pozita menaxheriale,
- Vetëdijesimi i rrethit shoqëror për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Pjesëmarrje në jetën politike:

- Kosova ka vendosur kuotën 30% të përfaqësimit në organet legjislativë, të shkohet përtej me sigurim e përfaqësimit edhe në nivele tjera,
- Mekanizmat qeveritarë nuk posedojnë instrumentet e duhura për të ushtruar ndikimin e duhur te institucionet tjera që jetësojnë ligjet, politikat apo strategjitë e hartuara nga këto institucione,
- Zbatimi i ligjit për trashëgimi të përmirësohet si masë për fuqizim të mëtutjeshëm të grave.


Mediat:

- Të fuqizojnë rolin e tyre në promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin në vendimmarrje.

Shoqëria civile:

- Të avokojë,
- Të llobojë,
- Të ofrojë shërbime që përkrahin avancimin e grave,
- Të promovojë barazinë në procesin e vendimmarrjes në të gjitha sferat.

Active CITIZENSHIP
KOSOVA



Kjo fletëpalosje ka për qëllim informimin e qytetarëve, në veçanti grave, mbi Ligjin për barazi gjinore. Grupi jo formal i grave, gratë asambleiste, gratë aktive në komunitet dhe organizatat e grave kanë bërë të mundur realizimin e kësaj fletëpalosjeje për të lehtësuar qasjen dhe informimin e qytetarëve, konkretisht të grave, mbi të drejtat e tyre. Fletëpalosja ka dalë si nevojë nga aktivitetet e grupeve të grave në kuadër të iniciativës “Rritja e pjesëmarrjes së gruas në proceset vendimmarrëse” e cila realizohet nga grupi jo formal i grave, gratë asambleiste dhe organizata partnere e tyre, OJQ “Zana”, që realizohet në kuadër të projektit “Qytetari Aktive” që realizohet Syri i Vizionit dhe mbështetet financiarisht nga Olaf Palme Interencional Center dhe SIDA.

RITJA E PJESËMARRJES
SË GRUAS NË PROCESET
VENDIMARRËSE



Mundësitë dhe të drejtat e barabarta në procesin e vendimmarrjes për gratë janë një sfidë në nivelin global, përderisa në Kosovë vazhdojnë të mbesin pothuajse të pa adresuara.

Baza ligjore dhe gruaja në vendimmarrje

Kur flitet për bazën ligjore në raport me barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje, duhet cekur se Kosova ka një bazë ligjore që garanton dhe promovon barazinë ligjore. Fillimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridiko-politik, përveçse në gjuhën dhe strukturën e saj ka një balancë gjinore, ajo respekton dhe promovon parimet e barazisë gjinore, që janë të pranuar edhe ndërkombëtarisht (Neni 71). Megjithëse, problematike mbetet ende zbatimi i saj në sektorin publik dhe atë privat.

Ligji për Barazi Gjinore, i cili në veçanti synon të mbrojë, të trajtojë dhe të vendosë barazinë si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave, dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor, e në të gjitha fushat e jetës shoqërore (Neni 1.1).

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nxit dhe siguron përfaqësimin gjinor në institucionet publike në Kosovë, duke përcaktuar kuotën prej 30 për qind për përfaqësim gjinor në organet legjislativë, në nivel qendror dhe në atë lokal (Neni 111.6). Po ashtu, ligje të tjera janë që fuqizojnë pozitën e gruas janë Ligji i punës, Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

GRATË NË PROCESIN VENDIMMARRJES NË KOSOVË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, akti më i lartë juridik dhe politik i vendit, përveç se në gjuhën dhe strukturën e saj ka një balance gjinore, ajo respekton dhe promovon parimet e barazisë gjinore, që janë të pranuar edhe ndërkombëtarisht.

Edhe pse ka arritje dhe përmirësime në shumë fusha, arritja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrja e gruas në pozita vendimmarrëse lë për të dëshiruar. Kjo mund të vërehet në statistikat më poshtë:

Në nivel drejtues në Shërbimin Civil në Kosovë janë 89% burra - 11% gra, Në nivel menaxhimi në Shërbimin Civil në Kosovë janë 79% burra - 21% gra.

Mekanizma tjerë që janë krijuar me qëllim të garantimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në vendim marrje:

- Agjencia për Barazi Gjinore në ZKM;
- Institucioni i Ombudspersonit - Njësia për Barazi Gjinore;
- Zyrtaret/ët për barazi gjinore nëpër ministri;
- Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore.

Në nivelin lokal ekzistojnë mekanizma institucionalë për arritjen e barazisë gjinore:

- Zyrtarët/et për barazi gjinore në komuna,
- Komitetet komunale për barazi gjinore.

Procese esenciale dhe të domosdoshme që gratë të jenë pjesë e tregut të punës dhe vendimmarrjes janë:

Në familje:

- Familja është institucioni me rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes për barazi gjinore, dhe ku duhet zëri të dëgjohet,
- Gruaja duhet të jetë bashkëpjesëmarrëse në procesin e marrjes së vendimeve në familje prandaj duhet punuar shumë në ndryshime, sidomos në zonat rurale,
- Familja duhet të jetë një nga mbështetësit edhe në zhvillimin e karrierës së mëtutjeshme të femrave.

Në arsimim dhe shkollim:

- Sistemi arsimor luan rol esencial në ngritjen e vetëdijes shoqërore në aspektin gjinor, përmes programeve mësimore,
- Arsimimi dhe përgatitja profesionale është faktori kryesor në avancimin e grave në punë dhe në proceset vendimmarrëse,
- Institucionet duhet të krijojnë mekanizma apo instrumente për të ndihmuar shkollimin e gruas, e në veçanti nga zonat rurale.

Në punë dhe pjesëmarrje në jetën ekonomike:

- Procesi i punës është shumë esencial që gratë të kenë zë dhe të fuqizohen,
- Procesi i ngritjes në karrierë të jetë i drejt,
- Të sigurohet barazia në sistemin e pagesave mes gjinive,
- Të këtë harmonizim më të mirë të jetës personale me atë profesionale, që duhet të jetë mirë i balancuar nga të punësuarat,